

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: ENG IDEA SH.P.K.; SiB-Bka; Geo Limit SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	15.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **13.03.2023**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; SiB-Bka; Geo Limit SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-321-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-009-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; SiB-Bka; Geo Limit SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-321-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-009-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **07.03.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-321-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-009-2-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; SiB-Bka; Geo Limit SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-321-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-009-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **07.03.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **13.03.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Lidhur me pretendimin ankimor të Grupit të Operatorëve Ekonomik ENGIDEA SHPK&SIB-BKA SH.P.K.&GEO LIMIT SHPK se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me **Nenin 59** dhe **Nenin 72** të **LPP-së** ku ky GEO pretendon që është diskriminuar duke u eliminuar për arsye të pasakta dhe në mënyrë të jashtëligjshme, ne si **AK** japim këto përgjigje:

Ju sqarojmë që ne si **AK** ju kemi eliminuar juve si GEO konform **nenit 59** të **LPP-së**, pasi që ju nuk keni prezantuar kontrata të ngjashme(hartim të projekteve) në vlerën e kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë në shumë prej 400,000.00 Eurove.

Ju sqarojmë që data e publikimit të njoftimit për këtë procedurë të prokurimit ka qenë data 16.02.2023 dhe për bazë duhet të merren kontratat nga kjo datë deri në periudhën 3 vjeçare që i bije deri me datën 16.02.2020, të gjitha kontratat e nënshkruara dhe përfunduara brenda kësaj periudhe merren për bazë në vlerësim.

Lista e kontratave të prezantuar nga kompania liderë ENG IDEA SHPK ka gjithsejtë 4 kontrata të prezantuar, po e japim një shpjegim për secilën prej tyre:

- Nëse e shikojmë listën e kontratave të operatorit ekonomik **ENG IDEA SHPK** kontrata me numrin rendor **1** merret për bazë në vlerësim komplet vlera e referencës pasi që është brenda afateve kohore në periudhën 3 vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Vlera e kësaj reference është 90,438.32€
- Nëse e shikojmë kontratën me numrin rendor **2** data e nënshkrimit është 25.01.2019 dhe data e përfundimit është 24.01.2020 d.m.th kjo kontratë nuk mund të merret parasysh pasi që është jashtë datave të cilat merren për vlerësim, datat të cilat merren në konsideratë janë nga data e publikimit të njoftimit për kontratë e cila është 16.02.2023 deri me datën 16.02.2020. Vlera e kësaj kontrate nuk mund të merret parasysh dhe nuk futet në kalkulimi. Ju keni prezantuar listën e projekteve të dorëzuara për këtë kontratë ku nëse i shikojmë datat e dorëzimit të projekteve janë të gjitha të brenda vitit 2019. Po ashtu keni prezantuar

edhe një raport i projekt menaxherit të datës 07.10.2020 ku nëse i shikojmë kemi gjithsejta 5 situacione që janë dorëzuar për pagesë 4 prej të cilave janë në vitin 2019 ndërkaq vetëm situacioni i fundit është në vitin 2020.

Raporti i projekt menaxherit është i datës 07.10.2020 që është 6 muaj pas skadimit të kontratës.

- Kontrata me numrin rendor **3** merret për bazë komplet pasi që është brenda afateve kohore në periudhën 3 vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë
- Kontrata me numrin rendor **4** është nënshkruar me datën 09.10.2018 dhe është kontratë 3 vjeçare mirëpo nëse e shikojmë tek referenca e cila është lëshuar me datën 30.11.2021 aty ceket vlera e hartimit të projekteve është **45,421.00 €** dhe mbikëqyrja është **35,999.00 €** dhe vlera e mbikëqyrjes në këtë rast nuk mund të merret parasysh. Sepse kjo kontratë ka qene projektim dhe mbikëqyrje

Pas ri-shikimit nga ana e komisionit të vlerësimit vlera totale e hartimit të projekteve(kontratave të ngjashme) të operatorit ekonomik **ENG IDEA SHPK** në periudhën 3 vjeçare që mund të mirën për bazë është **150,799.32euro**

Lista e kontratave të prezantuar nga kompania liderë **SIB BKA(ARCH EMPIRE) LLC** ka gjithsejtë 7 kontrata të prezantuar, po e japim një shpjegim për secilën prej tyre:

- Kontrata me numrin rendor **1** nuk mund të merret për bazë pasi që të dy operatorët ekonomik **ENG IDEA SHPK** dhe **SIB BKA** janë anëtar të konzorciumit të të njëjtës kontratë dhe ne e kemi marrë në kalkulim vetëm njëherë dhe për këtë jeni pajtuar edhe ju si GOE në kërkesën për rishqyrtim të cilën e keni bere.
- Kontrata me numrin rendor **2** është nënshkruar me datë 11.09.2018 dhe ka përfunduar me datë 07.09-2020. Komisioni i vlerësimit në këtë pikë e vlerëson si pjesërisht të bazuar dhe kjo vlerë e kontratës mund të merret në konsideratë komplet vlera e kontratës e cila është **187,152.68€**
- Ndërkaq kontratat prej numrit rendor **3-7** merren për bazë në vlerësim komplet vlera e tyre pasi që janë brenda afatit 3 vjeçare.

Nga kjo shohim se operatori ekonomik **ENG IDEA SHPK** hartim të projekteve(kontrata të ngjashme) i ka:**150,799.32€** ndërkaq operatori **SIB BKA** hartim të projekteve(kontrata të ngjashme) i ka gjithsejtë **220,419.48€** dhe totali i kontratave të ngjashme të këtij grupi të operatorëve ekonomik është gjithsejtë **371,218.80 Euro**

Duke u bazuar nga kjo vlera e kontratave të ngjashme të kërkuara në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë ka qenë **400,000.00euro** ndërkaq grupi i operatorëve ekonomik **ENG IDEA SHPK& SIB-BKA&GEO LIMIT SHPK** ka prezantuar kontrata të ngjashme **371,218.80 Euro** dhe nuk është plotësuar kjo kërkesë dhe konform **nenit 59 të LPP-së** jeni eliminuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 2

Në lidhje me pretendimin tuaj për çmime jo normalisht të ulët, ju sqarojmë që ne si Autoritet Kontraktues e kemi iniciuar këtë aktivitet të prokurimit, duke parashikuar si kriter kryesor për dhënie të kontratës **çmimi më i ulët i peshuar (poentuar)**, pasi që nuk i kemi ditur sasinë indikativë, prandaj në këtë rast nuk mund të përdoret edhe arsyetimi i eliminimit për Çmime jo normalisht të ulëta në pozicione.

Ndërsa dispozitat e nenit 18.28 të RRUOPP-së e parashohin qartë se: *“Kurdo që autoriteti kontraktues nuk dinë sasinë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktojë pashët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull ose grup të artikujve në mënyrë që autoriteti kontraktues të përcaktojë se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit.*

Në rastet ku kriter kryesor për dhënie të kontratës është **çmimi më i ulët me poentim** atëherë nuk duhet praktikuar eliminimin me arsyetimin jo normalisht të ulëta në pozicione sepse edhe Sa i përket pretendimit lidhur me *Nenin 61 të LPP-së dhe Rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët(B57)* Autoriteti Kontraktues sqaron se kur kemi kriter çmimi më i lirë i poentuar eliminohen praktikat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertës e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjerë. Në këtë kuptim sqarohet se *Rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët(B57)* gjen zbatim te kriteri **Çmimi më i ulët**, por jo edhe tek kriteri **Çmimi më i ulët i poentuar**. Ju sqarojmë se edhe OSHP në shumë vendime të saj e ka konstatuar një gjë të tillë, p.sh në vendimin nr. **568/19, 590/19 876/19** dhe në shumë vendime tjera.

Duke u bazuar në kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, rezulton se Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar kërkesat e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit sa i përket kësaj kërkesë, dhe në këtë rezulton që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP-së dhe duke u respektuar edhe të gjitha dispozitat e LPP-së, prandaj refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE ankues **ENG IDEA SH.P.K.; SiB-Bka; Geo Limit SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë**

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit